

Fondi i Pensionit Privat Raiffeisen



Raport Mjor Dhjetor 2025

Informacion bazë

Administrimi i Fondit

Monedha

Vlera fillestare e kuotës

Shuma fillestare minimale

Shuma minimale pasuese

Komision në hyrje

Komision në dalje

Penalite ne rast terheqje te parakohshme

Komision Administrimi ne vit

Kosto per transferte fondesh nga pale te treta

Shoqëria
Raiffeisen Invest
sh.a

LEK

1,000

1,000

1,000

0%

0%

Sipas rregullores
se AMF-se

1.50%

Referojuni
informacionit ne
deget e RBAL

Objektivi i investimit dhe profili i investitorit

Fondi i Pensionit Privat është një mënyrë alternative kursimi, e përdorur ekskluzivisht për kursime afatgjata për vitet pas largimit përfundimtar nga puna. Ky fond zotërohet bashkërisht nga anëtarët e fondit dhe menaxhohet nga Shoqëria Administruese Raiffeisen Invest sh.a, në bazë të kontratës së lidhur me anëtarët e fondit.

Asetet e Fondit do të investohen sipas parimit të sigurisë afatgjatë dhe të një kthimi të përshtatshëm nga investimi, duke ruajtur një raport optimal mes rritjes së kursimeve për pension dhe riskut të marrë përsipër.

Fondi synon të ndërtojë një portofol të përbërë kryesisht nga tituj borxhi te emetuar nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë me maturim afatgjatë (me maturim më të lartë se një vit).


Profili i Riskut dhe Përfitimit

Risk i ulët

Përfitimet tipike më të ulëta

Risk i lartë

Përfitimet tipike më të larta



Fondi është në kategorinë e parë të Profilit të Riskut dhe Përfitimit, pra në kategorinë me risk më të ulët.


Treguesi i riskut dhe përfitimit korrespondon me një numër të plotë i cili përdoret për të renditur fondin në një nivel risku nga 1 në 7, sipas nivelit të rritjes së luhatshmërisë. Kategoria më e ulët nuk do të thotë që investimi në fond është pa risk. Ky tregues ka për qëllim tju informojë mbi luhatshmërinë e çmimit të kuotës së fondit bazuar në historikun e performancës së fondit. Të dhënat historike të përdorura për llogaritjen e treguesit nuk mund të përbëjnë një siguri të plotë për profilin e riskut në të ardhmen.

Të dhëna për Fondin në 31.12.2025

Vlera Neto e Aseteve	2,000,543,860
Numri i investitoreve	5,230
Cmimi i Kuotes	2,346.2956
*Kthimi vjetor nga investimi (31.12.2024 - 31.12.2025)	4.55%

*Tarifa e administrimit dhe tarifat e tjera te vazhdueshme zbriten përpara llogaritjes së kthimit nga investimi

Struktura e portofolit te investimeve ne 31 Dhjetor 2025



Ne kuader te politikës se investimit te fondit te Pensionit, investimet do te kryhen kryesisht ne bono thesari dhe obligacione, te emetuara ne tregun primar, duke patur parasysh qe aktiviteti i tregtimit te titujve te borxhit te emtuar nga Qeveria shqiptare ne treg sekondar eshte i kufizuar.

Instrumenti	Ne % te Aseteve te Fondit
Obligacione Thesari	99.4%
Depozita / Llogari rrjedhese	0.6%

Bonot e thesarit 12 mujore emetohen dy here ne muaj; Obligacionet 2 vjeçare nje here ne muaj; 10 dhe 15 vjeçare jane me te rralla, afersisht nje here ne tre muaj. Qeveria organizon ankande te obligacioneve referencë 5 dhe 3-vjeçare me frekuence nje here ne muaj per secilin maturitet. Strategjia e investimeve vazhdon te jete e fokusuar ne investime afatgjate.

Vlera neto e asetëve te fondit eshte rreth LEK 2 miliard ne date 31 Dhjetor 2025.


Zhvillimet dhe ecuria e normave te interesit te titujve te Qeverise Shqiptare gjate muajit Dhjetor

Asetet e Fondit Pension jane te investuara ne bono dhe obligacione te emetuara nga Qeveria e Republikes se Shqiperise dhe per kete arsye fondi eshte i ekspozuar ndaj ndryshimeve ne normat e interesit te ketyre titujve. Investimet impaktohen kryesisht nga zhvillimet ne tregun e brendshem sic jane ndryshimet ne normat e interesit te titujve te Qeverise Shqiptare.

Normat e interesit te titujve te emtuar nga Qeveria Shqiptare kane ndjekur nje trend renes gjate muajit Dhjetor. Yieldi i obligacionit 12 mujore rezultoi ne 2.444%, duke rene me 0.04% ne krahesim me ankandin paraardhes.

Persa i perket obligacioneve ne krahesim me ankandet e fundit: Yildi i obligacionit 2 vjeçar rezultoi ne 2.84%, duke rrene me 0.04% ne krahesim me ankandin paraardhes; Yildi i obligacionit reference 3 vjeçar rezultoi ne 3.79% duke rrene me 0.10%; Yildi i obligacionit reference 5 vjeçar rezultoi ne 4.264% duke rrene me 0.22%.

Grafiket me poshte japin nje pasqyre te ecurise se normave te interesit te bonove dhe obligacioneve te thesarit te emetuar nga Qeveria Shqiptare gjate periudhes 1-vjeçare Dhjetor 2024 – Dhjetor 2025. Per obligacionet reference 3 dhe 5 vjeçare jane paraqitur yield-et fikse te perlogaritura nga kuotimet e kontributoreve ne fund te muajit Dhjetor.




Performanca e fondit dhe ecuria e çmimit të kuotës deri në 31 Dhjetor 2025

Kthimi vjetor neto i fondit është **4.55%** per periudhen 31 Dhjetor 2024 – 31 Dhjetor 2025; Kthimin 10 vjeçar me baze vjetore fondi e ka 4.97%, ndersa kthimin qe nga lancimi e ka 5.85% me baze vjetore.

Çmimi i kuotes se Fondit te Pensionit ka ndjekur nje trend rrites dhe vlere e kuotes eshte rritur me **+0.38%** gjate muajit Dhjetor. Kthimi i fondit ndryshon ne varesi te kushteve te tregut, sic jane ndryshimet ne normat e interesit te titujve te Qeverise Shqiptare.


Rritja e normave te interesit te titujve te Qeverise do te ndikoje pozitivisht ne performancen e fondit te Pensionit, i cili mund te investoje me norma me te larta duke rritur kthyeshmerine e portofolit te investimit ne te ardhmen.

Ecuria e çmimit të kuotës Fondi i Pensionit Privat Raiffeisen



Ne 31 Dhjetor 2025	1 Vit	3 Vjet	5 Vjet	7 Vjet	8 Vjet	10 Vjet	Qe nga lancimi i fondit (31 Dhjetor 2010)
Ne % kthim vjetor i periudhes (p.a.)	4.55%	4.56%	4.44%	4.49%	4.62%	4.97%	5.85%

Kthimi vjetor historik i Fondit te Pensionit Privat Raiffeisen per çdo vit



Anetaret e fondit te Pensionit keshillohen te kene nje horizont sa me te gjate qendrimi ne fond (mundesisht deri ne moshen e pensionit, pese vjet para moshes se percaktuar ne Ligj) per te perfituruar nje kthim maksimal nga investimi, per te permiresuar standartin e jeteses ne moshen e pensionit dhe per te evituar penalitetet ne rast terheqje te parakohshme.

Të dhënat e kthimit nga investimi në të shkuarën janë vetëm ilustrative dhe nuk përfaqësojnë një premtim apo garanci për kthimin në të ardhmen. Te gjithë shembujt e tjere numerike, jane perdorur per qellime ilustrative dhe analize te te dhenave historike, dhe nuk duhen perdorur nga investitoret per te nxjerre konkluzione per te ardhmen.

Investitorët e mundshëm duhet të lexojnë Prospektin dhe Rregullat e Fondit. Raiffeisen Invest dhe forca shitese e fondit nuk garantojnë një kthim të caktuar të fondit. Informacioni mbi cmimin e përditësuar të kuotës, prospektin dhe rregullat e Fondit gjendet pranë zyrave të Raiffeisen Invest sha, në web site www.raiffeisen-invest.al, ose në degët e Raiffeisen Bank në Shqipëri.

www.raiffeisen-invest.al